

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PER STUDIMET E CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË

1. Të jenë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së fundit të përgjithshme dhe/ose asaj specifike sipas fushave, nga “Times Higher Education”- Renditja botërore e universiteteve, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit, ose të kenë përfituar financim/bursë në masën 75 për qind të shpenzimeve totale të parashikuara nga universiteti pritës (për tarifën e shkollimit dhe kosto të tjera të jetesës) në rastet kur universiteti është i akredituar dhe i mirënjohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Në rastin e dytë mbështetja financiare nga Fondi i Ekselencës nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 euro në vit;
2. Të pranojnë të punojnë, së paku, 3 (tre) vjet në Shqipëri, pas diplomimit në ciklin përkatës të studimeve për të cilin përfitojnë bursën ose pas përfundimit të të gjithë cikleve të studimit, nëse kandidati fitues vijon studimet në ciklet më të larta universitare;
3. Të jenë shtetas shqiptarë;
4. Të mos jenë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar;
5. Të mos përfitojnë bursë/financim të plotë në universitetin pritës apo nga donatorë të tjerë. Në rastet kur studenti përfiton një financim të pjesshëm nga universiteti pritës apo nga donatorë të tjerë, financimi nga Fondi i Ekselencës do të bëhet për diferencën e vlerës deri në vlerën maksimale të parashikuar nga universiteti pritës për vitin akademik (tarifa e regjistrimit dhe/ose shpenzime të tjera të jetesës dhe udhëtimit) në varësi të masës së fondit në dispozicion;
6. Të kenë përfunduar studimet parauniversitare me mesatare mbi 9, të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë vendit, për studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve universitare;
7. Të kenë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9, për shkencat natyrore dhe teknike, dhe mbi 9.5 për shkencat ekonomike e shoqërore, për studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve universitare.

DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESË KANDIDATI

1. Bursa e posaçme për studentët që ndjekin jashtë shtetit ciklin e parë dhe të dytë

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga website i MASR www.arsimi.gov.al);
2. Diplomat universitare te ciklit të parë dhe/ose të dytë të studimeve universitare së bashku me aneksin e notave;
3. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë.

2. Bursa e posaçme për studentët që do të ndjekin studimet e vitit të dytë e më tej në ciklin e parë dhe të dytë.

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga website i MASR www.arsimi.gov.al);
2. Certifikatë e notave dhe detyrimeve të shlyera nga kandidati për vitin akademik të mëparshëm dhe planin e studimit për programin që ndjek kandidati në universitetin pritës;
3. Vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen financiare nga ana e tij për kandidatin si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar)
4. Dokumentacionin justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar.